Testime me PCR kryhen edhe në Qendrën Rajonale të Shëndetësisë Publike në Gjilan

Prishtinë, 25 janar 2021

Ministri i Shëndetësisë Armend Zemaj bashkë më drejtorin e IKSHPK-së Naser Ramadani, kryesuesin e Bordit të SHSKUK-së dr. Xhevat Jakupi dhe kryetarin e komunës Lutfi Hazir, morëm pjesë në lëshimin në përdorim të pajisjeve PCR në Qendrën Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRSHP) IKShP në Gjilan.

“Nga sot, testet PCR mund të kryhen edhe në Qendrën Rajonale të Shëndetësisë Publike në Gjilan dhe kështu vijon decentralizimi dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore duke i ofruar edhe më pranë qytetarëve”, tha Ministri Zemaj.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i ka zgjeruar kapacitetet e veta testuese, duke pajisur me aparate për teste PCR, përveç Gjilanit edhe pesë qendrat e tjera rajonale të Shëndetësisë Publike që janë degë të IKShPK-së. Kështu, mbulohen të gjitha rajonet me këtë shërbim të nevojshëm në këtë kohë të pandemisë COVID-19.

Pajisja për teste PCR, tashmë është vënë në funksion dhe qytetarët e këtij rajoni, mund t’i kryejnë testet pa pasur nevojë të udhëtojnë në qendrat tjera për teste, derisa

projekti për sigurimin e aparaturave PCR, bashkë me material shpenzuese për qendrat rajonale, ka kushtuar 1.752.210 euro dhe është siguruar përmes Projektit të Shëndetësisë Kosovare (huamarrja nga banka Botërore).

Po sot, Ministri Zemaj vizitoi edhe Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan, ku u informua për funksionimin e rezervuarit të oksigjenit të siguruar e vendosur kohë më parë.

Qytetarët e hospitalizuar që kanë nevojë për oksigjen në këtë spital, kanë sasi të mjaftueshme si dhe furnizim të rregullt, në pajtim me protokollet e trajtimit.

“Krijimi i kushteve për profesionistët shëndetësorë, si mision yni parësor, çdo ditë e më shumë po realizohet, duke ua lehtësuar punën atyre por edhe besueshmërisë së qytetarëve ndaj përkujdesjes publike shëndetësore”, tha ministri Zemaj.

Më herët, po ashtu, spitali në Prizren dhe spitali në Gjakovë janë bërë me rezervuar të oksigjenit, procedurat po vazhdojnë në Pejë dhe në spitalet tjera të përgjithshme.

KUMTESË

23
janar 2021

Të nderuar qytetarë,

Duke pasur parasysh vlerësimin e situatës aktuale me COVID -19, sot kanë rezultuar 379 raste positive me COVID-19 që është numri më i madh të rasteve që nga 18 dhjetori i vitit të kaluar.

Numri i rasteve pozitive vazhdon të jetë i lartë dhe brengosë si pasojë e drejtëpërdrejtë e neglizhimit të masave.

Mos e nënvlerësoni virusin!

Pakujdesi na dërgon shumë shpejt në mbingarkesën e Institucioneve shëndetësore dhe shtimin e rasteve fatale.

IKSHPK përsërit thirrjen për zbatimin e të gjitha masave të përgjithshme dhe specifike për mbrojtjen nga pandemia COVID-19.

IKSHPK apelon tek të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit COVID-19, duke marrë parasysh

dispozitat e Ligjit për
parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, dhe vendimet në fuqi mbi masat
dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe
specifike për mbrojtjen nga pandemia COVID-19.

Në veçanti, bëjmë thirrje për zbatimin e
rekomandimeve dhe respektimin e masave kufizuese për aktivitetet publike,
përkatësisht kufizimeve për grumbullimin e qytetarëve dhe tubimeve publike.

Grumbullimi i qytetarëve pa maska dhe
mbajtje të distancës shton rrezikun e përhapjes së infeksionit përderisa virusi
SARS-COV-2 është prezent në mesin tonë.

Pakujdesia
e disa qytetarëve gjatë këtyre lëvizjeve dhe aktiviteteve, shton rrezikun e
përhapjes së infeksionit përderisa virusi SARS-COV-2 është prezent dhe kështu
mund të mbingarkohet sistemi shëndetësor me pasoja të pa parashikuara deri në
shpërthim e që mund të paraqes rrezik për jetën e qytetarëve.

Si
pasojë e mos bartjes së maskave nga ju, qytetarë të nderuar, po rrezikohet
shëndeti i juaj dhe i qytetarëve të tjerë dhe po rëndohet situata e
përgjithshme epidemiologjike që po mbahet nën kontroll me mund

të madh të
ekipeve të profesionistëve të Institutit Kombëtar.

Përpjekja
e madhe e përbashkët e derisotme mund të na shkojë huq për shkak të pakujdesisë
së mos përmbajtes së tri rregullave themelore, të cilat duhet të jenë
përditshmëri e jona edhe pa pandemi, e që nënkupton: mbajtjen e distancës
fizike, mbajtjen e maskave dhe larjen e duarve me kujdes disa herë në ditë, për
20-30 sekonda

Çdo
shkelje e rregullave nga kushdo do të konsiderohet rrezikim i shëndetit dhe
jetës së të tjerëve.

Nuk
ka të drejtë askush të rrezikojë jetën e të afërmve të tyre, të moshuarve dhe
personave me sëmundje kronike për shkak të pakujdesit dhe mos zbatimit të
rekomandimeve.

Apelojmë tek institucionet përgjegjëse,
përkatësisht Policia e Kosovës dhe inspektoratet përgjegjëse që të mbikëqyrin
me përpikëri dhe të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e
masave dhe vendimeve të tjera në fuqi në zbatim të Ligjit për parandalimin dhe

luftimin e pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës.

Qytetarë të nderuar,

Ju lutemi për kujdes të shtuar!

Që të shmangni shkaqet dhe pasojat e infeksionit:

Respektoni masat kufizuese për grumbullimet dhe tubimet publike!

Mbuloni gojën dhe hundën me maskë!

Mbani higjienën!

Respektoni distancën!